



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:216814

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05498864

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Club Gold” Sh.P.K. me numër unik identifikues 8100837676, me seli në Prishtinë, rr. “Ilaz Kodra”, nr.171, Lagja Dardania, të cilin me autorizim e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Kërveshi & Partners”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke vepruar sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – vlerësim malli, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur me datë 15.03.2024, në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse Avokat K.K., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Procedura gjyqësore në këtë konflikt administrativ **NDËRPRITET** për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake në procedurë penale.
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë në procedurë penale.

Arsyetim

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1069/22 të datës 12.07.2023, e ka aprovuar ankesën e paditësit, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.2220/21 të datës 10.02.2022 e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, duke udhëzuar

gjykatën që në rishqyrtim të administroj parashtresën e datës 21.01.2022 dhe regjistrin e pranimit të dërgesave postare me kredi e datës 21.01.2022, duke verifikuar që paditësja ka adresuar të metat e padisë brenda afatit ligjor dhe ka ndjekur udhëzimet e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e sipas nevojës të siguroj edhe prova shtesë, dhe nëse nga rrethanat e çështjes vlerëson se akti kontestues duhet anuluar atëherë të vendos në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit duke marrë aktgjykim të drejtë me dispozitiv dhe arsyetim të qartë dhe të bazuar në dispozita ligjore, i cili do të zëvendësonte aktin e anuluar.

Duke vepruar sipas udhëzimeve të Dhomës së shkallës së dytë, Gjykata ka rishikuar dokumentacionin dhe ka konstatuar se provat e kërkuara nga paditësi, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative i ka pranuar me datë 25.01.2022, e që vërtetohet nga dosja elektronike (2021:216814) e regjistruar në Sistemin për Menaxhimin e Lëndëve Gjyqësore (SMIL), mirëpo kopja fizike ka munguar në lëndë. Meqenëse dokumentacioni i dorëzuar nga paditësi si provë e bashkëlidhur ankesës ndaj aktvendimit të shkallës së parë, korrespondon me dokumentacionin e skanuar në sistemin SMIL, gjykata gjeti se padia është plotësuar nga paditësi ashtu siç edhe ishte obliguar me aktvendimin e datës 10.01.2022. Rrjedhimisht gjykata caktoi dhe mbajti seancën gjyqësore me datë 15.03.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, avokat K.K., dhe në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës i cili me parashtresën e datës 11.03.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të merr pjesë në seancë, andaj edhe kërkon nga gjykata që të vepron në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 i LKA-së.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndrojnë pranë padisë dhe petitumit të saj. Megjithatë e njofton gjykatën se paraqet kërkesë për pezullim të procedurës për shkak se për të njëjtën çështje është ushtruar aktakuzë nga Prokuroria Speciale e Kosovës për një numër të madh të subjekteve juridike-lojërave të fatit, përfshirë edhe përfaqësuesin e paditësit dhe paditësit "Gold Club" SH.P.K. me numër të rastit Ps.nr.01/2021 ku janë mbajtur seancat pranë trupit gjykues, janë dëgjuar të gjitha provat e PSRK-së dhe duke qenë se çështja juridike në këtë shqyrtim bazën e ka të njëjtë, vendimin e ATK-së, ka shtuar se vlerësojnë se është e nevojshme të pritët epilogu i çështjes penale të theksuar si më lartë. Gjykatës i dorëzoi kopjen e procesverbalit të fundit në procedurën penale të elaboruar si më lartë.

Gjykata në seancën gjyqësore pasi analizoj propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 32 të LKA-së, vendosi ta ndërpresë procedurën e shqyrtimit gjyqësor në këtë konflikt administrativ, për shkak të çështjes paraprake deri në nxjerrjen e vendimit të formës së prerë në procedurën penale e cila aktualisht është duke u udhëhequr në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti Special, ndaj të akuzuarit-pronarit e këtu paditësit. Sipas vlerësimit të gjykatës procedura penale ndaj pronarit të këtu paditësit ka filluar më herët dhe është në zhvillim e sipër dhe se çështja e cila është objekt i procedurës penale ndërlidhet direkt me çështjen e cila është objekt i shqyrtimit në këtë konflikt administrativ, andaj gjykata e vlerësoj të arsyeshme që të ndërpritet procedura gjyqësore, për shkak të çështjes paraprake në procedurë penale.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 81.C të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 32 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.83/22 datë 22.03.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.